



# PREPORTR



# Lufta në paqe e veteranit

BESA KALAJA, LEONIDA MOLLIQAJ

# Lufta në paqe e veteranit

Perceptimi se njerëzit e UÇK-së janë pasuruar, i krijuar nga një sistem kualifikues që vie nga liderët që i përkasin këtij historiku, demantohet gjerësisht nga gjendja reale e kategorive të dala nga lufta që nuk kanë lidhje me politikën, e që janë shumica e ish-ushtarëve të UÇK-së

## BESA KALAJA & LEONIDA MOLLIQAJ

Bindja se ish-pjesëtarët e UÇK-së jetojnë mirë prej se krahu i luftës erdhi në pushtet, duket të jetë një mit. Imazhin e dëmtuar nga individë që nga radhët e tyre morën dhe keqpërdorën pushtetin, ish-pjesëtarët e UÇK-së e luftojnë çdo ditë me shembuj konkret të sakrificës.

Pas përfundimit të luftës pjesa dërmuese e ushtarëve të UÇK-së iu bashkua ushtrisë së të papunëve në Kosovë, megjithëse disa nga ta u angazhuan në TMK dhe polici. Disa kategori lufte marrin pension ndërsa pjesa tjetër, veteranët, nuk kanë fare kujdes institucional. Një pjesë e veteranëve të luftës të rënduar shumë ekonomikisht marrin asistencë sociale, e që është e pamjaftueshme që të mbahet një familje e rëndomtë kosovare.

Të përfaqësuara dobët nga shoqatat e dala nga lufta e pastaj të shfrytëzuara nga partitë që erdhën në pushtet si të ashtuquajtura krahu i luftës, veteranët ndjejnë se ndajnë fatin me të gjithë qytetarët e Kosovës, të cilët kur kërkojnë punë thuajse gjithmonë duhet të kenë lidhje me partitë politike ose me grupe të tjera interesi. Disa madje thonë se edhe për shërim jashtë vendit, invalidët e luftës duhen të kenë lidhje të forta me partitë në pushtet, sepse edhe për nevojat si këto ata diskriminohen.

Raporte të ndryshme, të papërpunuara zyrtarisht, tregojnë për një numër të lartë të vetëvrasjeve të ish-ushtarëve të lirisë. Mbi 40 ushtarë të UÇK-së raportohet të jenë vetëvrasur pas luftës.

Preportr, në këtë hulumtim është marrë më shumë me kategorinë e veteranëve të luftës, pasi ndryshe prej kategorive të tjera që marrin një pension, veteranët pothuajse nuk gëzojnë asnjë beneficencë.

Ligji për kategoritë e luftës i miratuar në vitin 2012 lë pezull punën e veteranëve. Me këtë ligj atyre u njihet statusi kurse të drejtat, do t'i gëzojnë me një ligj tjetër. Për këtë me gjasë do të duhet shumë kohë pasi verifikimi i kësaj kategorie që u bë këto dy vitet e fundit zgjati shumë dhe u shoqërua me shumë pakënaqësi dhe me dyshime për manipulime.

Megjithatë kategoritë e tjera trajtohen pak më mirë. Mjetet që për çdo vit ndahen për këto kategori e që në vitin 2014 e kanë arritur shumën e 36 milionë eurove në shikim të parë duket se nuk janë pak. Por nevojat e kategorive të luftës janë shumë më të mëdha se sa marrja e një pensioni që për shembull të invalidët e luftës me shkallë invaliditeti deri 80 për qind shkon deri në gati 500 euro. Një invalid me këtë shkallë invaliditeti ka nevojë për trajtim të vazhdueshëm shëndetësor. Pensioni nuk i mbulon këto nevojat, as sistemi shëndetësor i Kosovës nuk i ka kapacitetet që t'u ofrojë ndihmën e kërkuar. Këto kategori detyrohen që për nevojat e veta të dalin për trajtim jashtë shtetit ku shërbimet janë dukshëm më të larta. Këtu u del në ndihmë Ministria e Shëndetësisë, prej të cilëve për disa muaj rresht kemi tentuar të marrim përgjigje se cila është

shuma e ndarë për kategoritë e luftës që kanë nevojë për trajtim jashtë shtetit, por që nuk kemi arritur të marrim këtë përgjigje.

### Pensionet e para me 2002

Që nga viti 2002 në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), janë regjistruar disa kategori të luftës dhe të gjitha përveç veteranëve marrin pensione.

Shqipe Krasniqi, kryesuese e Divizionit të Skemës në Departamentin e Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës (FIDL) në MPMS, thotë se ata i kanë implementuar të gjitha këto kategori, por kategoria e veteranëve nuk ka gjetur ende zbatim.

Personat që gjenden në listat e përfitim të pensioneve nga Ministria e Punës, kanë aplikuar në zyrat e kësaj ministrie për t'i realizuar të drejtat e tyre. Lista e pretendentëve është verifikuar nga vet Ministria e Punës. Krasniqi thotë se këtyre kategorive këto të drejta u takojnë me ligj dhe kompletimi i këtyre listave nuk ka të bëjë asgjë me listat që i kanë shoqatat e luftës. "...ne si institucion nuk kemi pasur të bëjmë fare me shoqatat e luftës".

Kategoritë e lartpërmendura përveç pensioneve gëzojnë edhe beneficencë tjera, siç janë: Rehabilitimi në banja, lirimi nga shpenzimet e energjisë elektrike, lirimi nga pagesa gjatë kontrolleve shëndetësore, dërgimi në pushime verore në det, si dhe përfitimi i fëmijëve të këtyre

KATEGORITË  
↓  
PENSIONI  
Shuma Rritja Prill 2014

Familjet e Dëshmorëve	Shuma	Rritja	Prill 2014
1 dëshmor	358.50 €	89.63 €	448.13 €
2 dëshmorë	428.70 €	89.63 €	537.76 €
3 dëshmorë	463.80 €	134.44 €	582.57 €
4 dëshmorë	498.90 €	179.26 €	627.39 €
> 4 dëshmorë	534.00 €	224.06 €	672.19 €

Familjet e të zhdukurve të UÇK-së	Shuma	Rritja	Prill 2014
1 i zhdukur	358.50 €	89.63 €	448.13 €
2 të zhdukur	428.70 €	89.63 €	537.76 €
3 të zhdukur	463.80 €	134.44 €	582.57 €
4 të zhdukur	498.90 €	179.26 €	627.39 €
> 4 të zhdukur	534.00 €	224.06 €	672.19 €

Invalidi me dëmtim trupor

Invalidët e luftës	Shuma	Rritja	Prill 2014
mbi 80 %	358.50 €	89.63 €	448.13 €
mbi 71-80 %	330.00 €	82.50 €	412.50 €
prej 61-70 %	315.00 €	78.75 €	393.75 €
prej 51-60 %	300.00 €	75.00 €	375.00 €
prej 41-50 %	285.00 €	71.25 €	356.25 €
prej 31-40 %	255.00 €	63.75 €	318.75 €
prej 20-30 %	180.00 €	45.00 €	225.00 €

Invalidi me kujdestar	Shuma	Rritja	Prill 2014
mbi 80 %	180.00 €	45.00 €	225.00 €

Invalidi me dëmtim trupor

Familjet e invalidëve të luftës pas vdekjes	Shuma	Rritja	Prill 2014
mbi 80 %	286.80 €	71.70 €	358.50 €
mbi 71-80 %	264.00 €	66.00 €	330.00 €
prej 61-70 %	252.00 €	63.00 €	315.00 €
prej 51-60 %	240.00 €	60.00 €	300.00 €
prej 41-50 %	228.00 €	57.00 €	285.00 €
prej 31-40 %	204.00 €	51.00 €	255.00 €
prej 20-30 %	144.00 €	36.00 €	180.00 €

KATEGORITË	PENSIONI		
	Shuma	Rritja	Prill 2014
<b>Familjet e Viktimave Civile</b>			
Familja e viktimit civil	135.00 €	33.75 €	168.75 €
<b>Familjet e të zhdukurve civil</b>			
1 i zhdukur	135.00 €	33.75 €	168.75 €
2 të zhdukur	162.00 €	33.75 €	202.50 €
3 të zhdukur	175.50 €	50.63 €	219.38 €
4 të zhdukur	189.00 €	67.50 €	236.25 €
> 4 të zhdukur	202.50 €	84.38 €	253.13 €
<b>Invalidët civil të luftës</b>			
mbi 80 %	122.00 €	30.50 €	152.50 €
prej 61-70 %	109.00 €	27.25 €	136.25 €
prej 40-60 %	96.00 €	24.00 €	120.00 €
<b>Invalidi me kujdestar</b>			
mbi 80 %	40.10 €	10.03 €	50.13 €
<b>Familjet e invalidëve civil të luftës pas vdekjes</b>			
mbi 80 %	98.60 €	24.55 €	123.25 €
prej 61-70 %	88.20 €	22.05 €	110.25 €
prej 40-60 %	77.80 €	19.45 €	97.25 €

Invalidi me dëmtim trupor

Invalidi me dëmtim trupor

kategorive për regjistrim në universitet dhe pagesa të semestrit gjatë shkollimit të tyre.

Preportr ka siguruar buxhetin e shpenzuar për këto kategori prej vitit 2005 deri në vitin 2014. Nga 4,960,962.50 euro sa ishte në 2005, në vitin 2014 ky buxhet e ka arritur shumën e afër 36 milionë eurove.

Për dallim nga ngritja e pensioneve vitin e kaluar për 25 përqind gjë që rriti edhe buxhetin e përgjithshëm, lëvizjet në shumën e përgjithshme të buxhetit erdhën si rezultat i rritjes së numrit të pjesëtarëve të këtyre kategorive ndër vite. Lulahatje të numrit të kategorive të luftës vërehen nga muaji në muaj, madje edhe këtyre viteve të fundit. Megjithatë ky fenomen sipas Krasniqit, pothuajse është i zakonshëm pasi që ka shumë familje që nuk e dinë se ata gëzojnë benficione nga qeveria. Ajo tregon se ka raste kur dikush që ka ardhur në Kosovë për të luftuar nga jashtë shtetit nuk ka pasur njohuri se mund të gëzojë pension për dëmet që i janë shkaktuar në luftë.

Në mungesë të një verifikimi të rregulluar me ligj për kategoritë në fjalë dhe pa ndonjë shpjegim më të detajuar, kjo rritje e për çdo vitshme e numrit të përfituesve përkatësisht buxhetit mbetet e pashpjegueshme. Verifikimi i fundit me gjasë mund t'i shuaj dilemat se në këto lista a kanë përfituar vetëm ata që vërtet janë kategori të luftës, apo ka pasur raste që edhe këtu të jenë bërë

manipulime.

Përkundër kësaj, çështja e veteranëve mbetet pezull. Ata madje nuk i përfshinë as Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, i cili veteranët vetëm i përmend si kategori e luftës dhe ua njeh statusin e veteranit.

Neni 12, pika 2 e këtij ligji thotë se të drejtat në benficione për veteranët e UÇK-së si dhe kriteret e kualifikimit për njohjen dhe realizimin e tyre do të rregullohen me ligj të veçantë.

Ligji për kategoritë e luftës është miratuar në vitin 2012. Para miratimit të këtij ligji, çështja e këtyre kategorive është rregulluar me një rregullore të UNMIK-ut nr. 2000\66. Tash kur ka përfunduar procesi i verifikimit të veteranëve, kanë lindur pakënaqësi, probleme, protesta...

Qeveria e Kosovës, ka ndarë 24 milionë euro për pensione të veteranëve, por që të realizohen ato, duhet të dalin listat zyrtare të verifikimit dhe të nxirret një udhëzim administrativ ku përcaktohen rregullat, kriteret e mënyrës së aplikimit, dokumentacioni i nevojshëm etj.

#### Kërkojnë jetë të dinjitetshme

Në luftë të përhershme për mbijetesë, në luftë me imazhin e dëmtuar pas luftës, ish-luftëtarëve të UÇK-së u kërkohet

pareshtrur të arsyetojnë kërkesat për trajtim të drejtë institucional.

Veteranët e luftës mendojnë se nëse qytetarët dalin vetë në terren do të bindeshin që shumica e luftëtarëve të UÇK-së nuk kanë luftuar që pas luftës të gëzojnë privilegje. Fakti që shumica prej tyre jetojnë në kushte minimale tregon se kishin besuar që duke luftuar, pasardhësit e tyre do të jetonin më mirë.

Xhevdet Qeriqi, një veteran i luftës dhe i plagosur në betejën e Pashtrikut më 14 dhjetor 1998, thotë se "assesi nuk më ka shkuar mendja që do të vij koha që unë do të marr pension të luftës". Ai më tej shton se "për ta bindur opinionin ka fakte sa të duash që le të dalin në terren dhe le ta shohin se veteranët e vërtetë që kanë luftuar për këtë vend, sot janë të pa punë, të pa shpresë dhe në një gjendje të mjerueshme".

Kërkesa e tyre për trajtim të drejtë institucional rezulton në kërkesën bazë për një jetë më të dinjitetshme e që shpesh barazohet qoftë edhe me një vend pune.

Ekrem Xheladini mban me nostalgji kapelën me emblemë të UÇK-së dhe veshur ka rroba të ushtrisë. "Vetëm një vend pune e dua", insiston ai.

Xheladini jeton me një ndihmë sociale që e merr nga shteti, të cilën thotë se më shumë se gjysmën e shpenzon vetëm për "bukë të thatë". "Jetoj me social 70 euro, 45 euro bukë të thatë më shkojnë", thotë ai.

Një ish-ushtar nga Ferizaj,

## SIPAS LISTËS SË MPMS-SË, PENSIONE MARRIN

**3464** INVALIDË TË LUFTËS

**355** FAMILJE TË TË ZHDUKURVE CIVIL

**36** KUJDESTARË PËR INVALIDË CIVIL

**2128** INVALIDË CIVIL TË LUFTËS

**4822** FAMILJE TË VIKTIMAVE CIVILE

**2005** FAMILJE TË DËSHMORËVE TË UÇK-SË

**75** KUJDESTARË PËR INVALIDË TË LUFTËS

**20** FAMILJE TË TË ZHDUKURVE TË UÇK-SË

**126** FAMILJE TË INVALIDËVE TË LUFTËS PAS VDEKJES

**89** FAMILJE TË INVALIDËVE CIVIL PAS VDEKJES

**6396** VETERANË FIGUROJNË TË REGJISTRUAR NË MPMS POR NUK MARRIN PENSIONE

► VAZHDON NGA FAQJA 3

luftëtar në Zonën Operative të Pashtrikut, ku edhe ka humbur njëren këmbë, është shumë elokuent në të folur dhe bashkëluftëtarët e quajnë më të mençurin prej tyre. Ai quhet Ylber Selmani. Ylberi u flet gazetarëve për Gjykatën Speciale dhe shpreh habinë se si miratimin për themelimin e saj e kanë dhënë njerëzit që kanë luftuar, duke aluduar kështu në qeveritarët. I vjen keq që ndonjëri prej djemve që ka luftuar gjatë luftës mund të bëhet viktimë e kësaj gjykatë.

Kur pyetet për kushtet në të cilat jetojnë kategoritë e luftës ai më shumë shpreh keqardhje për veteranët sesa për vete.

“Trajtimi i veteranëve të luftës nga institucionet nuk është bo qysh e kemi pritë, por secili e ka gjetë mënyrën si me jetu, në bazë të miqve, familjarëve apo partive politike. Kanë perfitu veç ata që kanë pasë ndonjë të afërm në institucione”, thotë ai.

Ylberi shprehet i zhgënjyer me atë se si janë trajtuar këto kategori pas luftës. Thotë që pensioni që e merr ia plotëson kërkesat për një shujtë ditore “por nuk m’i plotëson nevojat shëndetësore, nuk muj me bo tretman mjekësor me këto pare, veç proteza jem kushton 8000 euro”.

Thotë se 16 vite pas luftës, kërkojnë nga Qeveria e Kosovës, që këtyre kategorive t’ua kthejë dinjitetin.

Xhevdet Qeriqi, thotë se veteranët jetojnë në kushte shumë të vështira pasi shumë prej tyre përveç që nuk mund ta sigurojnë bukën nuk kanë as kulm mbi kokë.

Jetojnë në mjerim, një pjesë e madhe e tyre. Janë dhjetëra prej tyre që kanë bërë vetëvrasje. Një rast që ka marrë pjesë në grevën e fundit që kemi organizuar ne ka bërë vetëvrasje, thotë Qeriqi. Sipas tij, ai ka bërë vetëvrasje për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike edhe ngarkesave psiçike që ka pasur. “Askush nuk është marrë me të”.

**Komandantët hanë mollët, ushtarëve u mpihen dhëmbët**

Kur pyeten për imazhin që u krijua pas luftës për UÇK-në dhe luftëtarët e saj, ish-luftëtarët e lirisë e kanë një adresë ku të orientojnë. Thonë që ata që e dëmtuan luftën janë në qeveri. Bile me neveri thonë se janë pas atyre grilave, duke aluduar në rrethojat e qeverisë.

“Për luks e të mira tjera pyesni ata. Ata të luksit jetojnë prapa atyre grilave. Po t’i kishim kushtet e tyre ne nuk do të dilnim në protesta e as greva”, thotë Ylberi, invalid i luftës.

Shkelzen Gashi, studiues i shkencave të historisë, thotë se për fat të keq, është e vërtetë se imazhi

## Buxheti i shpenzuar nga viti 2005 për kategoritë e luftës

**2005**  
4,960,962.50 euro

**2006**  
5,333,262.75 euro

**2007**  
9,173,104.72 euro

**2008**  
17,877,712.51 euro

**2009**  
19,374,720.97 euro

**2010**  
23,509,162.79 euro

**2011**  
29,249,970.31 euro

**2012**  
30,205,298.52 euro

**2013**  
30,433,048.73 euro

**2014**  
35,988,761.02 euro

**“PËR LUKS E TË MIRA TJERA PYESNI ATA. ATA TË LUKSIT JETOJNË PRAPA ATYRE GRILAVE. PO T’I KISHIM KUSHTET E TYRE NE NUK DO TË DILNIM NË PROTESTA E AS GREVA”**

YLBERI  
INVALID LUFTE



## Pasuria e ish-komandantëve e deklaruar në AKK në 2014

**Agim Çeku**

ish-komandant i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së

**606,384.00 €**

**Sylejmani Selimi**

ish-komandant i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së

**269,500.00 €**

**Ahmet Isufi**

ish-komandant i Zonës Operative të Karadakut

**295,150.00 €**

**Ramush Haradinaj**

ish-komandant i Zonës Operative të Dukagjinit

**753,300.00 €**

**Rrahman Rama**

ish-komandant i Zonës Operative të Shalës

**273,000.00 €**

**Rrustem Mustafa-Remi**

ish-komandant i Zonës Operative të Llapit

**551,700.00 €**

**Sami Lushtaku**

Ish-komandanti i Zonës Operative të Drenicës

**2,224,250.00 €**

**“Sot, grindja e tyre rreth pushtetit reflektohet edhe mes elektoratit përkatës, atij të veteranëve. Së pari, këto shoqata lejuan që listat të ‘fryhen’ deri në 65,000 veta, kurse sot duhet të marrin përgjegjësi për zvogëlimin e tyre në më pak se 20,000 sosh. Të dy veprimet janë gabime tepër të rënda. ‘Redaktimi’ i listave të veteranëve është formulë për ngatërresa dhe koritje të plotë publike”**

**DUKAGJIN GORANI**

i atyre që kanë kontribuar për çlirimin e Kosovës nga Serbia është dëmtuar shumë. Për këtë nuk i bën fajtorë luftëtarët e thjeshtë. Edhe ai mendon që luftën e dëmtuan komandantët dhe drejtuesit e shoqatave të luftës përmes mënyrave më të këqija.

“Komandantët dhe ‘drejtuesit’ e shoqatave të kategorive të luftës, përmes vjedhjeve, plaçkitjeve, shantazheve, reketit e formave tjera kriminale e kanë njollësuar luftën. Nuk ka pothuajse asnjë komandant të çfarëdo niveli qoftë, që nuk është përfshirë në aktivitete të tilla kriminale”, thotë Gashi.

Ai thotë se është e pakuptueshme se pse personat që kanë luftuar ndershëm, e që beson se janë shumë, nuk ngriten kundër këtyre kriminelëve, të cilët sipas tij nuk janë më të fortë se Serbia.

Meqë jetojnë në kushte të rënda, kategoritë e luftës i bëjnë fajtorë institucionet që në shumicën e rasteve udhëhiqen nga njerëz që kanë qenë pjesë e luftës. Shumë komandantë të luftës sot mbajnë pozita të rëndësishme shtetërore, si në qeveri, kuvend dhe në Forcat e Sigurisë së Kosovës.

#### **Nëse don edhe me t’çu n’deti?**

Shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, marrin financime nga Buxheti i Kosovës. Ato kanë zyra në të gjitha komunat e Kosovës ku e ushtrojnë aktivitetin e tyre. Xhavit Jashari, nuk tregon se nga i marrin mjetet për ushtrimin e këtyre aktiviteteve. I pyetur se sa mjete marrin nga Qeveria e Kosovës, ai pranon se i marrin ato por nuk na tregon shumën duke konsideruar që ajo është tejet simbolike. Jashari thotë se marrin edhe ngapak ndihma nga komunat. Por Preportr, ka gjetur se këto shoqata marrin nga Qeveria e Kosovës çdo vit nga 1 milion euro. Këtë e konfirmon edhe Musa Demiri, udhëheqës i Divizionit për Komunikim Publik në Ministrinë e Punës.

Po ashtu shoqatat e luftës marrin për çdo vit nga 12 euro nga invalidët dhe veteranët në emër të anëtarësisë. Xhavit Jashari, përmend që janë diku 23 deri 25 mijë veteranë (intervista është bërë para publikimit të listave nga komisioni për verifikimin e veteranëve). Nëse janë 23 mijë veteranë që paguajnë anëtarësinë, atëherë shuma e supozuar të mblidhet është 276.000 euro në vit, nëse janë 25 mijë atëherë kjo shumë arrijnë 300.000 euro. Ndërsa invalidët janë diku 3500 që për anëtarësi i bie të paguajnë më shumë se 42 mijë euro në vit.

Kategoritë e luftës mbeten të papërfaqësuar edhe nga shoqatat, madje ata i kritikojnë ato se nuk kanë bërë mjaftueshëm për

ngritjen e çështjeve që ata i preokupojnë si gjenden materiale, atë shëndetësore, duke përmendur këtu traumat që ata i kanë pësuar gjatë luftës etj. Ata kanë thënë se shoqatat u janë vardisur partive politike, sidomos PDK-së. Dy shembuj e dëshmojnë këtë: rasti i Faik Fazliut që u bë këshilltar i ish-kryeministrit Hashim Thaçi dhe i Muharrem Xhemajlit, i cili në zgjedhjet e fundit nacionale ka qenë kandidat për deputet në listën e PDK-së.

Preportr, nuk ka arritur të gjej se cila është pasuria e Xhemajlit, por ajo e Faik Fazliut e deklaruar në AKK, kap shifrën e 152,500.00 eurove. Fazliu merr edhe pension si invalid i luftës. Shumë veteranë, invalidë dhe familje të dëshmorëve i kanë akuzuar këto shoqata se gjatë gjithë kohës kanë punuar vetëm për interesa personale.

Dukagjin Gorani, publicist, thotë se për fat të keq paaftësia e këtyre shoqatave ndihmoi që të prodhohet bindja se lufta për çlirim të atdheut të shndërrohet në një luftë për një vend pune apo për një pension.

Invalidi i luftës së UÇK-së, punën e shoqatave e zhvlerëson edhe më shumë. Ylber Selmani, thotë se ato krejt çfarë bëjnë është dërgimi i këtyre kategorive në det dhe në banjë.

“Shoqatat na ofrojnë vetëm trajtim në deti, na çojnë në Durrës. I bojnë listat qysh i bojnë ata, neve na thirrin brenda natës apo shkoni a s’po shkoni, nëse jo ka veteranë të tjerë që i plotësojnë listat. Domethënë qëllimi i tyre është me e bo një ekskursion në deti 10 ditë edhe në banjë 6 ditë”, thotë Selmani.

Përveç shoqatave të luftës, janë themeluar edhe disa organizata tjera që ngriten më shumë zërin për realizimin e të drejtave të këtyre kategorive.

Më i zëshmi është Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Luftëtarëve të UÇK-së, i udhëhequr nga Xhevdet Qeriqi. Qeriqi me shumë bashkëluftëtarë të tjerë kërkuan në vazhdimësi trajtim më të mirë për kategoritë e luftës.

Kërkesat e tyre i kanë paraqitur para qeverisë në vitin 2009 në një protestë që eskaloi, ku disa prej pjesëmarrësve hodhën në oborrin e qeverisë koktejl molotovi, për të cilin veprim më vonë u akuzuan nga EULEX-i, vetë Qeriqi dhe disa bashkëluftëtarë të tjerë. Në vitin 2011, ky Këshill organizoi një grevë dhe për disa ditë me radhë qëndruan para Qeverisë së Kosovës. Ata u larguan nga aty pasi morën premtimin që ligji për kategoritë e luftës do të miratohej shpejt. Pas një pritjeje të gjatë kategoritë e luftës u bënë me ligj në vitin 2012.

#### **“Armata” e veteranëve që përdorën në kohë fushatash**

Në prag të zgjedhjeve nacionale të vitit 2014, ideja e Muharrem Xhemajlit që në atë kohë e udhëhiqte Shoqatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, ishte themelimi i një partie të re që do të përbëhej vetëm nga veteranët. Ideja ishte që vetëm me përfaqësim në Kuvendin e Kosovës, kjo kategori do të luftonte më shumë për të drejtat e tyre. Në bazë të kalkulimeve që bëheshin me numrin e veteranëve, thuhej se kjo parti mund të dilte forca e tretë më e madhe në vend pas PDK-së dhe LDK-së. Xhemajli nuk u përkrah nga një numër i madh i veteranëve. Ai megjithatë u kandidua për deputet përkrah partisë më të madhe në vend e që po ashtu ka dalë nga lufta, Partisë Demokratike të Kosovës.

Gorani thotë se shoqatat e dala nga lufta rregullisht përjetohen si nëndegë të partive politike, sidomos të PDK-së dhe të AAK-së meqë janë këto dy parti ato që më së shumti e ndërlikojnë imazhin e vet me ‘vlerat e luftës’.

“Sot, grindja e tyre rreth pushtetit reflektohet edhe mes elektoratit përkatës, atij të veteranëve. Së pari, këto shoqata lejuan që listat të ‘fryhen’ deri në 65,000 veta, kurse sot duhet të marrin përgjegjësi për zvogëlimin e tyre në më pak se 20,000 sosh. Të dy veprimet janë gabime tepër të rënda. ‘Redaktimi’ i listave të veteranëve është formulë për ngatërresa dhe koritje të plotë publike”, thotë ai.

Procesin e verifikimit të veteranëve ai e sheh edhe më të dhimbshëm se sa është. Pakënaqësitë rreth këtij procesi Gorani, thotë se do ta sjellin punën deri në atë nivel sa do ta relativizojnë vlerën e statusit të veteranit.

Që veteranët kanë mbetur peng i dëshirave dhe nevojave të partive politike sidomos atyre të krahut të luftës, e që e përdorin këtë kategori për kohë fushatash e pranon edhe Xhevdet Qeriqi. Ai thotë se në kohë fushatash veteranët marrin gjithfarë lloj premtimesh nga partitë politike, por porsa përfundon fushata ata lihen në harresë.

Megjithatë, pritja se duhet të ketë beneficione nga pjesëmarrja është një specifikë gati e veçantë për Kosovë. “Lufta për çlirim të vendit është obligim, për të nuk ka privilegje. Ose merr pjesë në të, ose nuk merr – është kjo çështje e kriterëve personale morale e kombëtare. Mirëpo, në emër të pjesëmarrjes në luftë për çlirim të vendit nuk mund të kërkohen pensione”, mendon ndërkaq Gorani. Por Qeriqi thotë se ata nuk po kërkojnë asgjë më shumë sesa një jetë më të dinjitetshme.

# VENDET E REZERVUARA NË UP

Familjarët e kategorive të dala nga lufta për vite me radhë u regjistruan në Universitetin e Prishtinës, pa asnjë kriter vlerësues. Këto regjistrime janë bërë në bazë të disa memorandumeve bashkëpunimi në mes të Rektoratit të UP-së dhe shoqatave të dala nga lufta. Nuk ka shifër se sa studentë janë regjistruar me këtë praktikë. Listat me emra të kandidatëve që janë pranuar që nga viti 2007 janë me mungesa bazike të të dhënave gjë e cila ka lënë hapësirë për keqpërdorim. Vendimi i rektorit të ri për hedhjen poshtë të këtij bashkëpunimi është përcjellur me reagime të shumta

LEONIDA MOLLIQAJ & BESA KALAJA & KALTRINA ZHUSHI

Pas luftës statusin e studentit e morën mijëra vetë, ndonëse nuk kaluan provimin pranues. Familjarët e kategorive të luftës regjistroheshin në Univeristetin e Prishtinës, me dokumentin që merrnin nga shoqatat e dala nga lufta si vërtetim që i përkasin këtyre kategorive. Kandidatët i nënshtroheshin formalisht testit pranues sepse ata pranoheshin në fakultet pavarësisht rezultatit që arrinin në provimin pranues.

Kur në krye të universitetit erdhi Ibrahim Gashi, në vitin 2013, forma e aplikimit për regjistrim të këtyre kategorive ndryshoi. Gashi kishte kërkuar nga shoqatat që të formulonin një listë ku do të përfshiheshin të gjithë kandidatët për studentë, si formë për t'i ikur pranimit sporadik të këtyre kategorive. Si rezultat dy vite me radhë shoqatat e veteranëve, invalidëve të luftës dhe të familjeve të dëshmorëve të UÇK-së dërgonin listë në Rektorat të Universitetit të Prishtinës, ku përfshiheshin kandidatët për studentë, familjarë të kategorive të luftës. E këta të fundit nuk merrnin as mundin më të vogël që t'i verifikonin këto lista. Ishin shoqatat e dala nga lufta ato që kishin fjalën e fundit me rastin e përpilimit të listës se kush nga këto kategori mund të regjistrohet në UP.

Pranimi i studentëve si kategori e luftës është bërë që nga viti 2005 duke u thirrur në memorandume të arritura me organizatat e dala nga lufta. Memorandume këto që u jetësuan përvitshëm e që nuk kanë as mbështetje në ligjet e arsimit apo në vet Statutin e UP-së. Bazuar në këto memorandume kandidatët hyjnë në teste pranuese dhe pavarësisht a tregojnë rezultate të mira, emrat e tyre dërgohen në rektorat për regjistrim nga shoqatat e luftës.

Memorandumi i parë në këtë nivel bashkëpunimi u realizua në vitin 2005 në kohën kur për pak muaj ishte rektor Arsim Bajrami. Në bazë të këtij memorandumi kategoritë e luftës dhe familjarët e ngushtë të tyre do të ndihmoheshin nga universiteti në regjistrim, në ofrimin e lehtësirave financiare, mbështetje me bursa, literaturë falas etj.

Memorandumi i tillë nuk u zbatua në të gjitha pikat vetëm gjatë periudhës 2007-2009, kur Enver Hasani ishte rektor i UP-së. Atëbotë Hasani kishte vendosur që në fakultetet apo në degët më të ndjeshme si Arkitekturë në Fakultetin Teknik, Mjekësi dhe Filozofik të mos regjistrohen studentë që nuk tregojnë nivel të lartë në testin vlerësues.

#### Memorandum i ri, kritere të njëjta

Kjo praktikë regjistrimi në universitet pavarësisht kritereve, për familjarët e kategorive të luftës, është vënë sërish në jetë me t'u bërë rektor Mujë Rugova. Në vitin 2009 ai kishte nënshkruar një memorandum të ri bashkëpunimi me shoqatat e luftës, memorandum i cili është zbatuar deri në vitin 2014.

Në bazë të këtij memorandumi Universiteti i Prishtinës, merr për obligim për të ndihmuar familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranët e luftës dhe fëmijët e invalidëve dhe veteranëve të luftës në regjistrim si studentë të rregullt dhe me korrespondencë, në lirim dhe me pagesa e semestrace, mbështetje për bursa etj. Pra ky memorandum nuk përfshinë familjet e invalidëve dhe veteranëve por vetëm fëmijët e tyre. Pika e tretë e këtij memorandumit thotë se OVL, SHIL dhe SHFD të UÇK-së, obligohen për dërgimin e listave të studentëve të

kategorive të lartcekura, që do të përfitojnë nga ndihmesat e UP-së.

Edhe në këtë memorandum, sikur edhe në atë paraprak, parashihet vetëm ndihmesa në regjistrim e kategorive por jo regjistrimi me automatizëm. Këtë hapësirë në këto memorandume edhe ashtu pa bazë ligjore e shfrytëzuan shoqatat e dala nga lufta të cilat çdo vit kanë regjistruar numër të madh të studentëve që nuk kanë treguar rezultat në test pranues.

Xhavit Jasharit nga Shoqata e Familjarëve të Dëshmorëve të UÇK-së, thotë se asnjë student nuk është regjistruar me automatizëm. Sipas tij të gjithë i janë nënshtruar testeve.

Përderisa, Fadil Shurdha, nga Shoqata e Invalidëve, pranon që para vitit 2014 universiteti i ka regjistruar të gjithë kandidatët që kanë qenë në listat të cilat shoqatat i kanë dërguar në Rektorat, pa kaluar asnjë prag.

Për më tepër Rektorati asnjëherë nuk kishte verifikuar as edhe një listë që kishte pranuar nga këto shoqata, për të parë se a i takojnë të gjithë kandidatët kategorive të luftës.


Sipas Shkelzen Gashit, studiues i shkencave të historisë shoqatat i kanë fryrë listat të cilat i kanë dërguar në Rektorat, ndërsa shprehë bindjen që krerët e shoqatave të dala nga lufta kanë manipuluar dhe përfituar me listat në fjalë.

“Jam thellë i bindur që drejtuesit e këtyre shoqatave kanë bërë keqpërdorime të mëdha me këto lista duke regjistruar njerëz që nuk kanë kurrfarë lidhje me këto kategori, kryesisht me të holla, por nuk përjashtohen edhe forma tjera”, thotë Gashi.


Por Xhavit Jashari, thotë se të gjithë kandidatët që i janë propozuar UP-së kanë qenë familjarë

“JAM THELLË I BINDUR QË DREJTUESIT E KËTYRE SHOQATAVE KANË BËRË KEQPËRDORIME TË MËDHA ME KËTO LISTA DUKE REGJISTRUAR NJERËZ QË NUK KANË KURRFARË LIDHJE ME KËTO KATEGORI, KRYESISHT ME TË HOLLA, POR NUK PËRJASHTOHEN EDHE FORMA TJERA”

SHKELZEN GASHI



## Regjistrimi i kandidatëve të kategorive të luftës ndër vite



## Numri i studentëve të pranuar në UP sipas fakulteteve

të kategorive të luftës. “Secili fëmijë që ka dashur të regjistrohet në fakultet ka ardhur te ne, ka treguar emrin, mbiemrin dhe kategorinë që i përket dhe ne i kemi konfirmuar këto të dhëna në bazë të dokumenteve që posedojmë”, thotë Jashari.

Fadil Shurdha, poashtu thotë se nuk ka pasur asnjë keqpërdorim në listat që shoqata që ai drejton i ka dërguar në universitet publik. “Unë ju kam ofruar që për të gjithë personat që gjenden në listë të bëhet verifikimi për secilin veç e veç dhe ju kam ofruar edhe vërtetimet që prindërit e tyre janë invalidë të luftës prej Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Nuk ka pasë asnjë parregullsi, të gjithë ata që kanë qenë në listë janë fëmijë të invalidëve”, thotë Shurdha.

### Listat e dërguara nga shoqatat me mungesa bazike të të dhënave

Se sa ka qenë joserioz dhe i pakontrolluar regjistrimi i kandidatëve për studentë në UP, që janë dërguar nga shoqatat, tregon fakti se as shoqatat në fjalë e as rektorati nuk i posedojnë shifrat e kandidatëve të pranuar ndër vite. Sekretari i Përgjithshëm i Rektoratit, Esat Kelmendi, ka thënë për Preportr, se nuk ka shifra në Rektorat lidhur me numrin e studentëve që janë regjistruar në UP në bazë të këtyre memorandumeve. As shoqatat e luftës nuk na treguan numrin e studentëve që janë pranuar në UP, duke thënë se këto shifra duhet t’i ofrojë Rektorati.

Preportr, ka siguruar vetëm disa lista me emrat e studentëve që janë pranuar nga Rektorati i UP-së nga viti 2007 deri në vitin 2014. Këtu duhet përmendur se këto lista janë sporadike dhe nuk janë lista të kompletuara, prandaj edhe shifrat që paraqiten nuk janë shifra totale e studentëve që u pranuan.

Në bazë të këtyre listave që Preportr, arriti t’i sigurojë si rezultat i memorandumeve janë regjistruar 2686 studentë.

Listat e siguruar kanë mangësi elementare të të dhënave duke filluar nga mungesa e emrave të prindërve, pastaj mungesa e përshkrimit të departamentit dhe fakultetit ku aplikuan, mungesa e përshkrimit të statusit se ciles kategori i takojnë si dhe vendit të lindjes.

Nga 2686 kandidatë për studentë, 927 prej tyre nuk e kanë të përshkruar fare emrin e prindit. Gjithashtu 22 studentë nuk e kanë të përshkruar as fakultetin ku janë regjistruar, ndërsa departamentin nuk e kanë të specifikuar 281 studentë.

Nga të dhënat që figurojnë në lista, Fakulteti Ekonomik prinë në numrin e studentëve të pranuar, për të pasuar me Fakultetin e Edukimit e të Mjekësisë.

Problemi kryesor në këto lista është se vetëm 276 nga 2686 studentë e kanë të përshkruar statusin të cilit i takojnë, edhe në rastet kur statusi ka qenë i plotësuar është shënuar vetëm me shkurtësë psh. F.D, F.V që nuk kuptohet a është fjala për fëmijë apo familjarë të këtyre kategorive.

Meqenëse në asnjërin memorandum nuk është e përshkruar qartë kush nga familjarët e kategorive përfiton në UP, Preportr në rastet kur është shënuar shkurtësia F.D, F.V ose F.I ka llogaritur se bëhet fjalë për familjarët e tyre.

Nga këta 276 studentë, 192 kanë deklaruar se mbajnë statusin e familjarëve të veteranëve, 86 familjarë të dëshmorëve etj. Preportr, pasi ka kontrolluar mirë listat ka gjetur se janë regjistruar edhe kategori të cilat nuk janë të parapara në memorandume. Fjala është për fëmijë të invalidëve civil, fëmijë të të vrarëve civil, invalidë civil dhe familjarë të Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc (UÇPMB)

Poashtu vetëm 1050 studentë e kanë të përshkruar vendin e lindjes. Qytetet që prijnë për nga numri i studentëve që janë regjistruar me këtë bashkëpunim janë Drenasi dhe Skenderaj.

Këto lista gjysmake si dhe me mungesë të të dhënave elementare pamundësojnë çfarëdo përpjekje për analizim të këtyre të dhënave e sidomos për verifikim.

Nëse një kandidat për student nuk e ka fare emrin e prindit, si do të vërtetohet se ai është i biri/bija e dëshmorit, invalidit të luftës apo veteranit?!

### Nuk paguajnë semestrin, ushqimin as qëndrimin në QS

Këto memorandume përveç regjistrimit në UP, kategoritë e luftës dhe familjarët e tyre i kanë liruuar edhe nga pagesat e semestrit. Asnjëra palë që kishte nënshk-

ruar memorandumet nuk ka shifra sa studentë janë liruuar nga semestri në saje të këtij bashkëpunimi. Shoqatat thonë se studentët kanë aplikuar individualisht për lirim nga semestri kështuqë Rektorati duhet të ketë shifrën totale të studentëve të liruuar. Ndërsa në Rektorat thonë se nuk kanë statistika sepse edhe kategori të tjera sociale janë liruuar nga pagesa e semestrit rrjedhimisht ka qenë e vështirë për të bërë diferencimin.

Këto kategori kanë përfituar edhe nga Qendra e Studentëve. Kjo e fundit ka liruuar nga pagesat për banim dhe ushqim invalidët e luftës së UÇK-së, fëmijët e dëshmorëve, fëmijët e invalidëve të luftës (me shkallë invaliditeti 40% e më lart) dhe veteranët e luftës.

Shyhyrete Abdullahu, zyrtarë për informim në QS, tregon se kjo qendër ka pasur bashkëpunim me shtetë qendrore të shoqatave të dala nga lufta që nga viti 1999. “Ky bashkëpunim është formalizuar me memorandumin e vitit 2009 në mes të Qendrës së Studentëve, MASHT-it dhe shoqatave të dala nga lufta”, thotë Abdullahu.

Numri i studentëve nga kategoritë e luftës që kanë përfituar qëndrim në konvikte dhe ushqim në menzë pa pagesë sipas QS është rreth 450 studentë në vit.

Nëse marrim si shembull vitin 2013 me një llogaritje të shpejtë mund të shohim se një student i rregullt i nivelit bachelor nga këto kategori i ka kushtuar UP-së 300 euro në vit vetëm nga lirimi për pagesën e semestrit. Nga lirimi prej pagesës për ushqim në menzë,


një student i ka kushtuar Qendrës së studentëve 270 euro në vit ndërsa për qëndrim në konvikt 360 euro në vit. Kjo llogaritje është bërë duke ditur se studentët gjatë vitit 2013 kanë paguar 50 euro për semestër, 40 për banim dhe 30 për ushqim. Duke mbledhur lirimin nga pagesa e semestrit, ushqimit dhe banimit, del që një student i ka kushtuar diku 930 euro buxhetit të Kosovës për një vit akademik.

### Rektori i ri shfuqizoi memorandumin

Për herë të parë prej vitit 2005 kategoritë e dala nga lufta dhe familjarët e tyre hasën problem për t’u regjistruar në Universitetin e Prishtinës. Rektori i ri i UP-së, Ramadan Zejnullahu në vitin akademik 2014/15 mori vendim që asnjë student të mos regjistrohet në këtë universitet pa kaluar testin pranues, duke hedhur poshtë bashkëpunimin që ka ekzistuar në mes të UP-së dhe shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së.

Rreth 1000 ishte numri i kandidatëve për studentë që shoqatat e luftës kishin përfshirë në listën për regjistrim në UP këtë vit akademik. Vendimi që ktheu prapa këta kandidatë që nuk plotësuan kriteret për regjistrim në UP, irritoi shumë shoqatat e dala nga lufta, të cilat për vite me radhë kishin dërguar lista me familjarë të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së për regjistrim në universitetin publik, lista të cilat aprovohehin pa asnjë verifikim nga ana e UP-së.

Oborri i Rektoratit të Univer-



Numri i studentëve sipas kategorive

sitetit të Prishtinës, që nga marrja e këtij vendimi u bë vendi ku vazhdimisht protestuan shoqatat e dala nga lufta bashkë me familjarët e kategorive të luftës që nuk fituan statusin e studentit. Në këto protesta më të instrumentalizuar ishin kandidatët për studentë të cilët pretendonin se pavarësisht që në test nuk kishin marrë pikët e nevojshme, duhej ta merrnin statusin e studentit. Për këtë insistim, bazë i kishin vitet e kaluara kur regjistrimi i këtyre kategorive nuk u diskutua asnjëherë, por të gjithë ata që gjendeshin në listën e shoqatave të UÇK-së pranoheshin me automatizëm në cilin drejtim kanë dashur.

Kësaj here çështja doli ndryshe. Rektorin e mbështetën ish-kryeministri, kryeministri i tashëm, ish-komandantë zonash, analistë e profesorë universitar. Në të gjitha debatet e shtruar për këtë çështje të gjithë ishin të një zëri se duke i regjistruar këta fëmijë në këtë formë më së paku u ndihmohej atyre.

Edhe njohës të çështjes së arsimit, por edhe ish-luftëtarë të UÇK-së, dolën kundër regjistrimit me automatizëm. Ata deklaruan se kësaj kategorie duhet që t'i ofrohet çfarëdo ndihme tjetër, përveç regjistrimit me automatizëm, pasi që një regjistrim i tillë e demton sistemin arsimor dhe vetë këta kandidatë për studentë. Kjo u argumentua me faktin se nëse një nxënës e di që nga shkolla e mesme që do të regjistrohet në drejtimin që dëshiron, nuk do të ketë motiv për t'u përgatitur për provim pranues.

Gjithashtu u kërkua që të bëhet një kategorizim edhe tek përfitimet që marrin studentët, sepse nuk mund të konsiderohet njëjtë një

fëmijë i një veterani dhe një fëmijë i një dëshmorit, për faktin se ky i dyti është rritur në kushte jo të barabarta.

Në përballje me rektorin të vetme mbetën shoqatat e luftës që kërkonin me ngulm pranimin e të gjithë kandidatëve, emrat të cilëve i kishin dërguar në rektorat. Rektori u ofroi ndihmë në regjistrim vetëm fëmijëve të dëshmorëve të luftës, të cilët gëzuan pesë pikë bonus por gjithsesi që të pranoheshin si studentë në universitet duhej edhe t'i nënshtroheshin testit pranues dhe të kalonin prapë minimal prej 30%.

#### Padi për rektorin

Xhavit Jashari, përfaqësues i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, thotë se rektori Zejnullahu ka shkelur memorandumin dhe për këtë e ka paditur atë në gjykatë dhe tani janë duke e pritur vendimin e saj.

“Palët nënshkruese obligohen të respektojnë memorandumun, në qoftë se dikush dëshiron ta prish memorandumun duhet ta lajmërojë palën tjetër në afat minimal një muaj para se të ndodhë prishja e kësaj marrëveshje. Mjerisht një pjesë e këtyre studentëve kanë mbetë pa u regjistruar e çka është më e keqja pas zhgënjimit që e kanë marrë nga këto institucione shumica e tyre kanë marrë rrugën e migrimit”, thotë Jashari.

Edhe Fadil Shurdha nga Shoqata e Invalidëve të UÇK-së, ka kundërshtuar vendimin e rektorit për mosrespektim të memorandumit. Ai thotë se në memorandum thuhet se të gjithë invalidët dhe fëmijët e invalidëve të luftës të cilët aplikojnë regjistrohen dhe nuk ka pasur prapë të caktuar nga


universiteti.

“Por këtë vit na është kërku që ata studentë që nuk do ta kalojnë prapë nuk do të jenë në atë fakultet ku kanë aplikuar por në ndonjë fakultet tjetër, por as ajo nuk ndodhi”, thotë Shurdha.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KM-DLNJ), pati mbështetur rektorin Zejnullahu në vendimin e tij për ndërprerjen e regjistrimeve pa kritere në Universitetin e Prishtinës.

“Përkrahim fëmijët e dëshmorëve dhe kategorive të tjera të dala nga lufta duke u krijuar lehtësira gjatë vendosjes në konvikte, ndarjes së bursave, lirimit nga taksat dhe pagesa e semestrave si dhe abonimit në mensë, lirimi i pagesës në transport publik, shërbimet shëndetësore etj., por fuqishëm e kundërshton regjistrimin në bazë të automatizmit duke e shkelur konkursin”, thuhej në komunikatën e KMDLNJ-së.

Analisti Shkelzen Gashi, mendon se kërkesat e shoqatave të luftës janë të padrejta dhe se regjistrimi i studentëve në UP duhet të bëhet në bazë të kriterëve. “Pranimi i këtyre studentëve e ka përkeqësuar gjendjen edhe ashtu fort të rëndë në UP. Fëmijët e dëshmorëve dhe të invalidëve duhet të kenë përparësi, si për shembull: lirim nga pagesa e semestrit, lirim nga pagesa e materialeve mësimore (libra, skripta), pastaj bursa mujore, e me radhë, sepse duhet t'i nderojmë maksimalisht ata që kanë sakrifikuar për çlirimin e Kosovës nga Serbia. Por, regjistrimi i këtyre fëmijëve duhet të jetë sikurse edhe i të gjithë fëmijëve tjerë”, thotë Gashi.



Numri i studentëve të pranuar në UP sipas qyteteve

“PËRKRAHIM FËMIJËT E DËSHMORËVE DHE KATEGORIVE TË TJERA TË DALA NGA LUFTA DUKE U KRIJUAR LEHTËSIRA GJATË VENDOSJES NË KONVIKTE, NNDARJES SË BURSIVE, LIRIMIT NGA TAKSAT DHE PAGESA E SEMESTRAVE SI DHE ABONIMIT NË MENSË, LIRIMI I PAGESËS NË TRANSPORT PUBLIK, SHËRBIMET SHËNDETËSORE ETJ., POR FUQISHËM E KUNDËRSHTON REGJISTRIMIN NË BAZË TË AUTOMATIZMIT DUKE E SHKELUR KONKURSIN”

KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT